



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 163

11 tetor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 49/2013, datë 3.10.2013	Për lirimin nga detyra të zonjës Albana Shtylla si anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 7313
Vendim i Kuvendit nr. 50/2013, datë 3.10.2013	Për lirimin nga detyra të zotit Denar Biba si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve..... 7313
Vendim i Kuvendit nr. 51/2013, datë 3.10.2013	Për lirimin nga detyra të zotit Jani Jani si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve..... 7314
Vendim i KM nr. 846, datë 27.9.2013	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të disa objekteve dhe truallit funksional, pjesë e pronës nr. 84, me emërtim “Ish-regjimenti i kimisë”, me vendndodhje në Shtish-Tufinë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 7314
Vendim i KM nr. 848, datë 27.9.2013	Për shfuqizimin e vendimit nr. 655, datë 7.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për heqjen nga fondi kullosor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë kullosore “Mali i Rrencit-Kakarriq” Lezhë, që do të përdoret nga shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k. për shfrytëzimin e gurit gëlqeror”..... 7316
Vendim i KM nr. 874, datë 4.10.2013	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik..... 7316
Vendim i KM nr. 877, datë 3.10.2013	Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit..... 7317
Vendim i KM nr. 931, datë 9.10.2013	Për krijimin e Task - Forcës për marrjen e masave të ndërhyrjes emergjente për mbrojtjen mjedisore dhe rehabilitimin e territorit..... 7318

Vendim i KM nr. 932, datë 30.9.2013	Për unifikimin e kompetencave të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) në zonat me rëndësi kombëtare dhe në territor.....	7319
Vendim i KM nr. 933, datë 9.10.2013	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me përfaqësues, në seksionin e zbulimit të Forcave të Operacioneve Speciale (SOFFC), të Shtabit të Operacioneve Speciale të NATO-s (NSHQ), në operacionin ushtarak “ISAF”, në Afganistan.....	7320
Vendim i KM nr. 936, datë 9.10.2013	Për largim dhe emërim në detyrë.....	7322
Udhëzim i MPB nr. 534, datë 30.9.2013	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme të parakohshme për kryetar të bashkisë Korçë, qarku Korçë dhe të komunës Karbunarë, qarku Fier.....	7322
Vendim i GJK nr. 40, datë 30.9.2013	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit, brenda afatit të arsyeshëm, të vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.....	7327
Vendim i GJL nr. 3, datë 8.7.2013	Me objekt kundërshtimin e urdhrit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr. 43, datë 2.4.2012, për ekzekutimin e vendimit penal nr. 19, datë 24.3.2000 (nr. 36, datë 23.4.2007) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.....	7333
Vendim i ERE nr. 95, datë 13.9.2013	Mbi miratimin e kërkesës së TAP AG, për modifikim të përkufizimit të origjinës së gazit, sipas pikës 4.1.1 të vendimit për miratimin e Opinioni të Përbashkët Përfundimtar.....	7345
Vendim i ERE nr. 96 datë 13.9.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Bardhgjana” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Bisak” si burim i rinovueshëm energjie.....	7347
Vendim i ERE nr. 98, datë 13.9.2013	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. me nr. 112, seria PV10K, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 110, datë 22.12.2010.....	7348
Vendim i ERE nr. 99, datë 13.9.2013	Për modifikimin e licencës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Hec – Lanabregas” sh.a.....	7349
Vendim i ERE nr. 100, datë 13.9.2013	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërive “Hec Bistrica 1, Bistrica 2” sh.a., “Hec Ulëz Shkopet” sh.a. për transferimin e asetëve dhe të licencave të prodhimit, tregtimit dhe furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike nga këto shoqëri te shoqëria “Kurum international” sh.a.....	7350
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Rudin Arapi.....	7350
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Veliko Memushaj.....	7350

VENDIM
Nr. 49/2013

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ZONJËS ALBANA SHTYLLA SI ANËTARE E
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Albana Shtylla lirohet nga detyra e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shkak se ka dhënë dorëheqjen.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 3.10.2013

VENDIM
Nr. 50/2013

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ZOTIT DENAR BIBA SI ANËTAR I KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Denar Biba lirohet nga detyra e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shkak se ka dhënë dorëheqjen.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 3.10.2013



VENDIM
Nr. 51/2013

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ZOTIT JANI JANI SI ANËTAR I KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Jani Jani lirohet nga detyra e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shkak se ka dhënë dorëheqjen.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 3.10.2013

VENDIM
Nr. 846, datë 27.9.2013

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, TË DISA OBJEKTEVE DHE
TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË E PRONËS NR. 84, ME EMËRTIM “ISH-REGJIMENTI
I KIMISË”, ME VENDNDODHJE NË SHTISH-TUFINË, TIRANË, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të disa objekteve dhe truallit funksional të tyre, me sipërfaqe të përgjithshme 37 100 (tridhjetë e shtatë mijë e njëqind) m², pjesë e pronës nr. 84, me emërtim “Ish-Regjimenti i Kimisë”, me vendndodhje në Shtish-Tufinë, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’i përdorur për ngritjen e një vendqëndrimi për strehimin e familjeve të komunitetit rom.

2. Sipërfaqja prej 37 100 (tridhjetë e shtatë mijë e njëqind) m², pjesë e pronës nr. 84, me emërtim “Ish-Regjimenti i Kimisë”, me vendndodhje në Shtish-Tufinë, Tiranë, sipas pikës 1 të këtij 7314

vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.


3. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së kësaj prone, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministri i Punëve të Brendshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN - VENDOSJA E REP.USHT.NR. 1005 KOMP.MADM (prona 84)
Objektet dhe sip.e përgjithshme që kërkohej për kalim në administrim të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë)





VENDIM
Nr. 848, datë 27.9.2013

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 655, DATË 7.8.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HEQJEN NGA FONDI KULLOSOR TË SIPËRFAQES NË
NGASTRAT E EKONOMISË KULLOSORE “MALI I RRENCIT-KAKARRIQ” LEZHË, QË
DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “COLACEM ALBANIA” SHPK PËR
SHFRYTËZIMIN E GURIT GËLQEROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 2.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 655, datë 7.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për heqjen nga fondi kulloror të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë kullorore “Mali i Rrencit-Kakarriq”, Lezhë, që do të përdoret nga shoqëria “Colacem Albania” sh.p.k., për shfrytëzimin e gurit gëlqeror”.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 874, datë 4.10.2013

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË KRYETARIT TË KOMISIONIT TË
PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 19/2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Lealba Pelinku, kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik, lirohet nga kjo detyrë dhe vijon mandatin e anëtarit të këtij komisioni.

2. Denar Biba emërohet kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 877, datë 3.10.2013

PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Territorit, si autoritet kombëtar i planifikimit, kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje:

- | | |
|---|------------------|
| - Ministrin e Zhvillimit Urban dhe Turizmit | zëvendëskryetar; |
| - Ministrin e Punëve të Brendshme | anëtar; |
| - Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës | anëtar; |
| - Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | anëtar; |
| - Ministrin e Drejtësisë | anëtar; |
| - Ministrin e Kulturës | anëtar; |
| - Ministrin e Energjisë dhe Industrisë | anëtar; |
| - Ministrin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | anëtar; |
| - Ministrin e Mjedisit | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Zhvillimit Urban dhe Turizmit | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit | sekretar. |

2. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Territorit, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen me 20 000 (njëzet mijë) lekë.

3. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Territorit të përballohet nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës që ata përfaqësojnë.

4. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e zhvillimit të mbledhjes, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT), zbardh vendimet e KKT-së, të cilat ua dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit të Këshillit, dhe Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

5. Vendimi nr. 87, datë 7.2.2012 i Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen të gjitha institucionet, përfaqësuesit e të cilave janë përcaktuar në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 931, datë 9.10.2013

**PËR KRIJIMIN E TASK - FORCËS PËR MARRJEN E MASAVE TË NDËRHYRJES
EMERGJENTE PËR MBROJTJEN MJEDISORE DHE REHABILITIMIN E TERRITORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe të Ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Task - Forcës në nivel kombëtar për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen mjedisore dhe rehabilitimin e territorit, e emërtuar "Task - Forca për Mbrojtjen e Territorit".

2. Task - Forca për Mbrojtjen e Territorit drejtohet nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe ka në përbërje:

- Ministrin e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- Ministrin e Mjedisit;
- Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës;
- Ministrin e Kulturës;
- Ministrin e Mbrojtjes;
- Kryeinspektorin e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale;

- Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Task - Forca për Mbrojtjen e Territorit ka këto funksione:

a) Analizimin e problematikës së ndërtimit dhe vlerësimin e nevojës për ndërhyrje emergjente, për masa të mbrojtjes në të gjithë territorin, si dhe në veçanti dhe me përparësi në zonat e përcaktuara, si zona të rëndësisë kombëtare, me ligj, akte nënligjore apo me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT).

b) Evidentimin e zonave me interes kombëtar, në të cilat do të zbatohen masat e ndërhyrjes emergjente për rehabilitimin dhe mbrojtjen mjedisore të territorit.

c) Miratimin projektplanit të veprimit të ndërhyrjeve në këto zona dhe në të gjithë territorin dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tij.

ç) Përcaktimin e përparësive për zbatimin e ndërhyrjeve emergjente në të gjitha zonat dhe objektet, të cilat paraqesin karakteristika të veçanta kulturore, historike, sociale, arsimore, shëndetësore, mjedisore, turistike, industriale apo infrastrukture etj., mjedisi i të cilave është dëmtuar/shkatërruar nga zhvillimi i ndërtimeve.

d) Përcaktimin e objektivave e të masave për bashkërendimin e punës me organet e qeverisjes vendore dhe me strukturat e tjera, të specializuara, për monitorimin dhe analizimin e problematikës për realizimin e ndërhyrjeve konkrete.

4. Task - Forca për Mbrojtjen e Territorit mblidhet një herë në javë ose në çdo kohë me kërkesë të kryetarit.

5. Në mbledhjet e Task - Forcës për Mbrojtjen e Territorit ftohen të marrin pjesë përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore dhe të institucioneve të tjera të interesuara, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre do të jetë e vlefshme për përmbushjen e misionit të saj.

6. Kryetari i Task - Forcës për Mbrojtjen e Territorit i raporton pas çdo mbledhjeje Kryeministrit për ecurinë, problematikat e hasura, masat e ndërmarra dhe rezultatet konkrete të

arritura. Kryetari i Task-Forcës, me kërkesë të Kryeministrit, raporton pranë Kryeministrit edhe për çështje të veçanta.

7. Task - Forca për Mbrojtjen e Territorit ndihmohet nga sekretariati teknik. Ngarkohen Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Ministri i Punëve të Brendshme për ngritjen e sekretariatit teknik dhe përcaktimin e përbërjes e të mënyrës së funksionimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 932, datë 30.9.2013

**PËR UNIFIKIMIN E KOMPETENCAVE TË INSPEKTORATIT NDËRTIMOR
URBANISTIK KOMBËTAR (INUK) NË ZONAT ME RËNDËSI KOMBËTARE DHE
NË TERRITOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 10, 10/1 e 16 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) i ushtron pa asnjë kufizim paraprak kompetencat e përcaktuara në nenet 9, 10 e 10/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, në çdo rast kur ai konstaton objekt të kundërligjshëm, me ose pa leje ndërtimi, në të gjitha zonat e përcaktuara, si zona të rëndësisë kombëtare, me ligj, akte nënligjore apo me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT).

2. Në rastet kur INUK-ja konstaton objekte në ndërtim e sipër në të gjithë territorin, përfshirë edhe zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare, dhe kur Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) dhe/ose autoriteti përgjegjës i planifikimit nuk ka zbatuar përgjegjësitë ligjore të përcaktuara në nenin 83 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, atëherë INUK-ja ushtron menjëherë kompetencat e përcaktuara në nenet 9, 10 e 10/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007.

3. INUK-ja ushtron menjëherë me autoritet të plotë përgjegjësitë e përcaktuara në nenet 9, 10 e 10/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007, për të gjitha objektet e kundërligjshme, me ose pa leje ndërtimi, në të gjithë territorin kur konstaton se INUV-ja e komunës/bashkisë ka kryer veprime ose mosveprime në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore, të parashikuara në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007.

4. INUK-ja, qoftë edhe kryesisht, kryen inspektime dhe kur është rasti ushtron kompetencat e përcaktuara në nenet 9, 10 e 10/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” në të gjitha zonat e rëndësisë kombëtare, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, si dhe pranë të gjitha zonave dhe objekteve, të cilat paraqesin karakteristika të veçanta kulturore, historike, sociale, arsimore, shëndetësore, mjedisore, turistike, industriale apo infrastrukturore etj, kur mjedisi i tyre është dëmtuar, apo shkatërruar tërësisht nga zhvillimi i ndërtimeve të objekteve:

- a) pa leje ndërtimi;
- b) me leje ndërtimi, por të realizuara me shkelje të kushteve urbanistike të lejeve të ndërtimit;



c) me leje ndërtimi të kundërligjshme;

ç) dhe të strukturave/ndërtimeve në proces legalizimi, të cilat bien në kundërshtim me kërkesat ligjore, të përcaktuara në vendimin nr.438, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar objektet në ndërtim apo që legalizohen ose jo”. Në këto raste, është ALUIZNI autoriteti përgjegjës, i cili konfirmon moskualifikimin për legalizim të këtyre objekteve dhe njofton INUK-në.

5. Për efekt të ushtrimit të përgjegjësisë të INUK-së në territorin e zonave me rëndësi kombëtare apo të zonave të miratuara në KKT, çdo ndërtesë/strukturë nëntokësore dhe/ose e ngritur mbi tokë, në fazën fillestare apo të përfunduar të ndërtimit, e përhershme apo e përkohshme, e lidhur në mënyrë të qëndrueshme ose të përkohshme me truallin, konsiderohet objekt i kundërligjshëm kur rezultojnë se gjendet në njërin apo disa nga kushtet e mëposhtme:

a) Është pa leje ndërtimi;

b) Është me leje ndërtimi, por me shkelje të plotë të kushteve urbanistike të miratuara në lejen e ndërtimit, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe/ose në kundërshtim me planet, kombëtare apo vendore, të zhvillimit;

c) Për këtë objekt ka kaluar afati ligjor i përcaktuar në lejen e ndërtimit për përfundimin e objektit dhe/ose objekti është braktisur nga investitori/subjekti ndërtues/pronari;

ç) Është pa dokumentacion tekniko-ligjor që të vërtetojë ligjshmërinë tekniko-ligjore të objektit;

d) Objekti rezultojnë me shkelje të lejes së legalizimit ose me leje legalizimi të miratuar në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi për legalizimet.

6. Policia e Shtetit, kur konstaton punime ndërtimore të kundërligjshme në të gjithë territorin, merr masat ligjore përkatëse dhe njofton menjëherë INUK-në.

7. Në ushtrimin e kompetencave në prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme INUK-ja bashkëpunon dhe mbështetet nga Policia e Shtetit.

8. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit të nxjerrë udhëzime të hollësishme metodike për zbatimin e praktikës së unifikuar sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 933, datë 9.10.2013

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME PËRFAQËSUES, NË SEKSIONIN E ZBULIMIT TË FORCAVE TË OPERACIONEVE SPECIALE (SOFFC), TË SHTABIT TË OPERACIONEVE SPECIALE TË NATO-S (NSHQ), NË OPERACIONIN USHTARAK “ISAF”, NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11, të nenit 14, të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të 1 (një) përfaqësuesi ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Kabul, Afganistan, në seksionin e zbulimit të Forcave të Operacioneve Speciale (SOFFC), të Shtabit të Operacioneve Speciale të NATO-s (NSHQ), në kuadër të operacionit ushtarak "ISAF".

2. Përfaqësuesi ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të jetë i emëruar me detyrë në strukturat e kohës së paqes (PE), të Shtabit të Operacioneve Speciale të NATO-s (NSHQ), në Chever, Mons, Belgjikë.

3. Misioni i përfaqësuesit ushtarak në seksionin e zbulimit të Forcave të Operacioneve Speciale (SOFFC), të Shtabit të Operacioneve Speciale të NATO-s (NSHQ), në kuadër të operacionit ushtarak "ISAF", në Kaia/Kabul, Afganistan, është kryerja, zhvillimi dhe mbështetja në çështjet e zbulimit, përpunimit të informacionit, shpërndarjes dhe integritetit të operacioneve të forcave speciale të NATO-s, të angazhuara në operacionin ushtarak "ISAF", nëpërmjet vendosjes së kontakteve të rregullta me individët, stafet, organizmat që punojnë për NATO-n (shtabet, komandat dhe forcat e sigurisë së NATO-s, në operacionin "ISAF") dhe organizmat e inteligjencës në fushën e zbulimit duke përfshirë disa disiplina me qëllim sigurimin dhe dhënien e instruksioneve, udhëzimeve e të këshillave për mbështetjen e ecurisë së operacioneve dhe personelit të aleancës në operacionin "ISAF", Afganistan.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 6 (gjashtë) muaj, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit ushtarak në Afganistan. Kohëzgjatjes së misionit i shtohen edhe ditët e qëndrimit për marrjen dhe dorëzimin e detyrës në zonën e operacionit.

5. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për përfaqësuesin ushtarak, pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

a) shpërbimin për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) mbështetje shëndetësore;

ç) shërbim telefonik, postar dhe internet;

d) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në raste vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

dh) akomodim (energji elektrike, fjetje, ngrohje, ujë);

e) ushqim;

ë) lavanderi;

f) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;

g) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i cili do të marrë pjesë në këtë mision.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 936, datë 9.10.2013

PËR LARGIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pika 1 e 26, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Hysni Burgaj largohet nga detyra e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe lë gradën “Drejtor i Përgjithshëm”.

2. Z.Artan Didi emërohet drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe i jepet grada “Drejtor i Përgjithshëm”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 534, datë 30.9.2013

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME TË PARAKOHSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KORÇË, QARKU
KORÇË DHE TË KOMUNËS KARBUNARË, QARKU FIER**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 49, 50, 59 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të dekretit nr. 8332, datë 20.9.2013 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të bashkisë Korçë, qarku Korçë”, të dekretit nr. 8333, datë 27.9.2013 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të komunës Karbunarë, qarku Fier”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Ekstraktet e përbërësve zgjedhorë dhe listat e zgjedhësve gjenerohen automatikisht në afatet që parashikon ligji nga RKGJC-ja dhe janë të vlefshme në ndërfaqen grafike *online* të RKGJC-së. Procedura e gjenerimit të ekstrakteve dhe listave të zgjedhësve është funksionalitet i sistemit të RKGJC-së, ku përgjegjësi i ZGJC-së shkarkon nga RKGJC-ja përbërësit zgjedhorë për zgjedhësit që i përkasin kësaj ZGJC-je, si më poshtë: te menuja në të majtë zgjedh opsionin “Procesi i regjistrimit”, “Raportime” dhe zgjedh listën.

2. Brenda datës 7 tetor 2013, RKGJC-ja gjeneron formatin elektronik të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhjeve të 3.11.2013, të ndarë sipas qendrave të votimit, duke shtuar dhe të gjithë shtetasit me vendbanim në bashkinë Korçë dhe komunën Karbunarë, të cilët në datën 3.11.2013 mbushin moshën 18 vjeç.

3. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile kontrollojnë menjëherë raportin ditor për numrin e zgjedhësve për çdo qendër votimi. Kur vëren në raportin ditor të datës 7.10.2013 se ka qendra

votimi me më pak se 200 zgjedhës, apo qendra votimi me më shumë se 1000 zgjedhës, njofton brenda ditës kryetarin e bashkisë/komunës. Këto lista gjenden në formatin e posaçëm, kanë të shkruar në sfond “jo për afishim” dhe mund të përdoren vetëm për ndarjen apo bashkimin e qendrave të votimit sipas ligjit, por në asnjë rast nuk mund të përdoren për afishim, apo në faza të tjera të procesit zgjedhor. Gjithashtu, në format të posaçëm është edhe lista e zgjedhësve mbi 100-vjeçarë në datën e zgjedhjeve. Kjo listë i njoftohet kryetarit të bashkisë/komunës për të bërë njoftimin e këtyre shtetasve për arsyen e mospasqyrimin në listë. Në format të posaçëm është edhe lista e zgjedhësve që e kanë numrin e qendrës së votimit të ndryshëm nga qendrat e votimit që i përkasin kësaj zyre të gjendjes civile.

4. Lista e zgjedhësve është e grupuar sipas zonave të qendrave të votimit. Kufijtë e zonave të qendrave të votimit janë ato të zgjedhjeve të fundit. Kryetari, i cili ka marrë njoftimin nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, vendos bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë, të qendrave të votimit.

5. Në rastet e qendrave të votimit me fraksion që kalojnë limitin numerik të përcaktuar në ligj, kryetari vendos ndarjen e tyre duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë dhe jo çdo fraksion veç e veç. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi me gjithë fraksionet e saj, do të ndahet në pjesë të barabarta me jo më shumë se 1000 zgjedhës.

6. Për qendrat e votimit me më pak se 200 zgjedhës, kryetari vendos bashkimin e kësaj qendre me qendrën më të afërt me mundësi komunikimi rrugor e me më shumë se 200 zgjedhës. Nëse shuma e numrit të zgjedhësve për qendrat që do të bashkohen është më shumë se 1000 zgjedhës, atëherë kryetari pas bashkimit të këtyre qendrave, vendos ndarjen me fraksion të tyre. Nëse dy a më shumë qendra votimi kanë më pak se 200 zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël i bashkohen qendrës me numër më të madh zgjedhësish.

7. Vendimet e kryetarit për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit, nëse ka të tilla, do t'i dërgohen në formë shkresore zyrës së gjendjes civile për zbatim dhe Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për dijeni, jo më vonë se 2 ditë nga marrja e informacionit nga zyra e gjendjes civile.

8. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, me marrjen e vendimit të kryetarit për ndarjen e qendrave të votimit, kryen veprimet e mëposhtme: në menunë majtas zgjedh <administrimi i qendrave të votimit>, zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të ndahet, plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “Sipas vendimit nr. ____, datë ____.2013 të kryetarit”, shtyp butonin <Ruaj>. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të asaj dite. Në rast mosndryshimi, sistemi i RKGJC-së ekzekuton automatikisht kërkesën për ndarjen e qendrës së votimit sipas kriterit numerik dhe mbiemrit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës bazë.

9. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile, me marrjen e vendimit të kryetarit për bashkimin e dy a më shumë qendrave të votimit, kryen veprimet si më poshtë: Në menunë majtas zgjedh <administrimi i qendrave të votimit>, zgjedh numrin e qendrës së votimit që do të mbyllet, si dhe numrin e qendrës së votimit pritëse.

Plotëson fushën e përshkrimit me shënimin “Sipas vendimit nr. ____, datë ____.2013 të kryetarit”, shtyp butonin <Ruaj>. Ky informacion mund të ndryshohet deri në orën 24:00 të asaj dite. Në rast mosndryshimi, sistemi i RKGJC-së ekzekuton automatikisht kërkesën për bashkimin e qendrave të votimit sipas vendimit të kryetarit.

10. Kryetari i bashkisë/komunës brenda datës 21.9.2013 bën njoftimin me shkrim të zgjedhësve të përfshirë në ekstraktin e printuar sipas qendrave të votimit brenda territorit të bashkisë/komunës. Njoftimi për shtetasit do të jetë sipas modelit nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Gjithashtu, brenda këtij afati, kryetari njofton edhe shtetasit me moshë mbi 100 vjeç për arsyen e mospërfshirjes së tyre në listë, sipas modelit nr. 2 bashkëlidhur.



11. Zgjedhësit, të cilët kanë marrë njoftimin me shkrim nga ana e bashkisë/komunës dhe konstatojnë se në përbërësit e tyre zgjedhorë ka mospërputhje, i drejtohen zyrës së gjendjes civile përkatëse për të bërë rregullimet e mundshme brenda datës 23.10.2013, datë kur duhet të printohet lista përfundimtare e zgjedhësve.

12. Në rast se kryetari nuk përmbush detyrimet sipas pikës 4, 5, 6 dhe 7 të këtij udhëzimi deri në printimin e listës të datës 23 tetor 2013, DPGJC-ja kryen menjëherë ndarjen dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit sipas kritereve të përcaktuara në ligj, të cilat reflektohen në listat e zgjedhësve të datës 3 nëntor 2013.

13. Të drejtën për kërkesë e kanë dhe shtetasit që kanë mbushur moshën 100 vjeç. Këta shtetas do të bëjnë kërkesë për ndryshim të qendrës së votimit nga 8899, qendër imagjinare e përdorur nga sistemi vetëm për këtë grup zgjedhësish, në qendrën e votimit sipas vendbanimit. Kjo kërkesë realizohet nëpërmjet formularit, sipas modelit nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

14. Krahës ndryshimit të përbërësve zgjedhorë në rrugë administrative, zyra e gjendjes civile do të pasqyrojë edhe rastet e vendimeve të gjykatës, deri në ditën e printimit të listës së zgjedhësve.

15. Zyra e gjendjes civile në bashki/komunë në datën 23.10.2013 printon nga RKGJC-ja dhe firmos listën e zgjedhësve për çdo qendër votimi, nën juridiksionin territorial të saj, dhe ia dorëzon kryetarit.

DPGJC-ja publikon këtë listë në faqen e saj zyrtare.

16. Kryetari miraton dhe firmos listën dhe e dërgon brenda datës 25.9.2013 në të tria formatet e parashikuara në KZAZ-në përkatëse.

17. Një kopje e listës së zgjedhësve në format të printuar i dërgohet menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

18. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryetari i bashkisë Korçë, i komunës Karbunarë, zyrat e gjendjes civile përkatëse dhe institucionet e tjera shtetërore që parashikohen në Kodin Zgjedhor.

19. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

Qarku: _____
Bashkia/Komuna _____
Numri i banesës: ###

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet pjesshme per kryetar komune/ bashkie, ju jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimit numër #####, me adresë: _____

Z./Zn	Razije	Rapaj	Gani	I datelindjes	24/08/1942	Nr ne	175
Z./Zn	Xhafer	Rapaj	Hysni	I datelindjes	17/07/1969	Nr ne	176
Z./Zn	Rajmonda	Xhindi	Nazmi	I datelindjes	22/03/1977	Nr ne	204

Kryetari i Bashkisë/Komunës

Firma: _____

QARKU: _____
Bashkia/ Komuna _____
Numri i banesës: ###

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet pjesshme per kryetar komune/ bashkie, ju jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimit numër #####, me adresë: _____

Z./Zn	Biliman	Spahiu	Syrja	I datelindjes	19/11/1960	Nr ne	178
Z./Zn	Kozeta	Spahiu	Estref	I datelindjes	01/03/1965	Nr ne	179
Z./Zn	Manjola	Spahiu	Biliman	I datelindjes	06/12/1990	Nr ne	180

Kryetari i Bashkisë/Komunës

Firma: _____

QARKU: _____
Bashkia/ Komuna _____
Numri i banesës: ###

DATA E ZGJEDHJEVE: ##.##.####

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet pjesshme per kryetar komune/ bashkie, ju jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimit numër #####, me adresë: _____

Z./Zn	Agron	Isufaj	Jonus	I datelindjes	05/06/1965	Nr ne	115
Z./Zn	Alketa	Isufaj	Vasfi	I datelindjes	06/06/1972	Nr ne	116

Kryetari i Bashkisë/Komunës

Firma: _____

QARKU: _____
Bashkia/ Komuna _____
Numri i banesës: ###

DATA E ZGJEDHJEVE: ##.##.####

Ju njoftojmë se për Zgjedhjet pjesshme per kryetar komune/ bashkie, ju jeni të regjistruar në listën e qendrës së votimit numër #####, me adresë: _____

Z./Zn	Niazi	Totolaku	Nedim	I datelindjes	28/11/1947	Nr ne	196
Z./Zn	Nazlie	Zeneli	Ruzhdi	I datelindjes	18/04/1947	Nr ne	211

Kryetari i Bashkisë/Komunës

Firma: _____



MODEL 2

NJOFTIM

DATA E ZGJEDHJEVE: __/__/__

QARKU: _____

Bashkia / Komuna: _____

Numri i banesës: _____

Z./Znj. _____

Ju njoftojmë se për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë/Komunës, sipas nenit 51 të Kodit Zgjedhor nuk jeni të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit si shtetas që keni mbushur 100 vjeç. Sipas nenit 53 të Kodit Zgjedhor për tu përfshirë në listën e zgjedhësve, kërkesa e juaj duhet të bëhet pranë zyrës suaj të gjendjes civile.

KRYETARI

(Emër, Mbiemër, Firma)

MODEL 3

KËRKESË

Drejtuar: Bashkisë / Komunës : _____

Unë i quajtur _____ banor i Bashkisë / Komunës
(emër, atësi, mbiemër)

_____ pasi mora njoftimin nga Kryetari se nuk jam i përfshirë në listën e zgjedhësve, kërkoj nga ana juaj, të më shtoni në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit Nr _____, aty ku janë të regjistruar dhe pjesëtarët e tjerë të familjes.

Emër, Mbiemër

(nënshkrimi)

Data: __/__/__

VENDIM
Nr. 40, datë 30.9.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	anëtar i Gjykatës Kushtetuese, drejtues i seancës
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 13.6.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen nr. 16 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Minerva Kotherja, përfaqësuar nga Endri Kotherja, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Ministria e Drejtësisë, të përfaqësuara nga Avokati i Shtetit, Armer Juka, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit, brenda afatit të arsyeshëm, të vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17/2, 41, 42/1, 44, 118/1, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, 13, neni 1 i protokollit nr. 1 dhe protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, pretendimet e përfaqësuesit të kërkuësës, i cili kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet e përfaqësuesit të subjekteve të interesuara, i cili kërkoj rrëzimin e kërkesës, dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja Minerva Kotherja është njëra prej trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit Shefikat Bylykbashi, i cili, me vendimin nr. 373/2, datë 27.7.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Elbasan, është njohur pronar për pasurinë prej 2 490 m² truall dhe është vendosur kompensimi në vlerë për këtë sipërfaqe, pasi është konsideruar truall i zënë.

2. Me kërkesën e datës 12.1.2009, kërkuësja i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) Tiranë, për përfitimin e kompensimit financiar, për sipërfaqen e truallit prej 2 490 m².

3. Me shkresën nr. 67/1 prot., datë 16.1.2009, AKKP-ja i ka kthyer përgjigje kërkuësës se duhej të paraqitej pranë këtij institucioni pas njoftimit të datës për aplikim, pasi afati për paraqitjen e kërkesave kishte filluar në datën 3.11.2008 dhe kishte përfunduar në datën 3.12.2008.

4. Kërkuësja i është drejtuar gjykatës me padë, me objekt “*Detyrimi i të paditurit, AKKP-ja Tiranë të nxjerrë aktin përkatës administrativ për realizimin e të drejtës së kompensimit në vlerë në favor të Shefikat Bylykbashit (trashëgimtarëve), si pronar i tokës truall në qytetin e Elbasanit.*”



5. Me vendimin nr. 1340, datë 24.2.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurit, AKKP-ja Tiranë, të nxjerrë aktin administrativ lidhur me kërkesën e paditëses Minerva Kotherja për kompensimin në vlerë të pronës.”*

6. Me vendimin nr. 2172, datë 25.10.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të gjykatës së shkallës së parë.

7. Me kërkesën e datës 25.9.2012, kërkuësja i është drejtuar AKKP-së për ekzekutimin vullnetar të detyrimit që rrjedh nga vendimet gjyqësore.

8. Me kërkesën e datës 24.10.2012, kërkuësja i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë, në mënyrë që ky i fundit të ushtrojë kompetencat ligjore, të parashikuara në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës, për ekzekutimin e detyrimit nga ana e AKKP-së.

9. Me shkresën nr. 2672/1 prot., datë 7.12.2012, Ministria e Drejtësisë i është drejtuar AKKP-së, duke i kërkuar marrjen e masave për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pasi veprime të tilla sjellin zvarritje të procesit të kompensimit.

10. Me shkresën nr. 4101/1 prot., datë 27.12.2012, AKKP-ja i është përgjigjur Ministrit të Drejtësisë se nga verifikimet pranë këtij institucioni rezulton se kërkuësja nuk ka aplikuar për kompensim financiar dhe, në këto kushte, ky institucion nuk mund të shprehet me vendim për pronën e pretenduar. Po ashtu, AKKP-ja e orienton kërkuësen që të aplikojë pranë këtij institucioni nga data 30.11.2012 deri në datën 28.12.2012, në përputhje me procedurat e përcaktuara në VKM-në nr. 768, datë 7.11.2011 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012”.

11. Me kërkesën e datës 17.1.2013, kërkuësja i është drejtuar përsëri Ministrit të Drejtësisë, me kërkesë me të njëjtin objekt si më sipër.

II

12. Me kërkesën e datës 20.3.2013, **kërkuësja Minerva Kotherja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ajo pretendon se, pavarësisht detyrimit që lindte nga vendimi gjyqësor dhe qëndrimit të Ministrit të Drejtësisë për marrjen e masave përkatëse, AKKP-ja është përgjigjur se kërkuësja më parë duhej të aplikonte për kompensimin dhe se ajo nuk mund të shprehej me vendim. Në këtë mënyrë, AKKP-ja Tiranë, nëpërmjet sjelljes së saj, ka cenuar të drejtën e kërkuëses për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

13. **Subjektet e interesuara, AKKP-ja Tiranë dhe Ministria e Drejtësisë**, në parashtrimet drejtuar Gjykatës shprehen se:

13.1 AKKP-ja e ushtron veprimtarinë në zbatim të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, i cili parashikon edhe rregullimin me akte nënligjore nga Këshilli i Ministrave, të procedurave, rregullave dhe kritereve që ajo duhet të zbatojë për shpërndarjen e fondit të kompensimit në të holla. AKKP-ja ka në kompetencën e saj njohjen e të drejtës së pronësisë dhe dhënien e vendimit për kthimin e pronës ose kompensimin e saj, si dhe vlerësimin e masës së kompensimit, por ajo nuk ka në kompetencë të vendosë pagesën e kompensimit pa një vendim të Këshillit të Ministrave.

13.2 Kërkuësja nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në kushtet kur konstatohet se ajo vetë nuk ka respektuar procedurat e kërkuara nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi, për të vënë në lëvizje procedimin administrativ. Nga verifikimet e kryera pranë AKKP-së, rezulton se kërkuësja nuk ka paraqitur asnjë kërkesë brenda afateve të përcaktuara me VKM për vitin kalendarik respektiv.

13.3 Kërkuesja keqinterpreton dispozitivin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, i cili nuk shprehet për detyrimin e AKKP-së për të bërë pagesën e kompensimit, por për nxjerrjen e aktit lidhur me kërkesën për kompensim.

13.4 E drejta për një proces të rregullt duhet të konkurrojë me parimin e barazisë së shtetasve, në këtë rast. Organi administrativ e realizon këtë procedurë për të gjitha subjektet e shpronësuar, përfaqësuesit e tyre, konform të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në të njëjtën mënyrë dhe sipas të njëjtave kushte.

13.5 Bazuar në vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në çështjen “Manushaqe Puto etj. kundër Shqipërisë”, datë 31 korrik 2012, qeveria ka marrë të gjitha masat dhe po punon për hartimin e “Strategjisë kombëtare për pronën”. Aktualisht, me VKM-në nr. 350, datë 29.4.2011, qeveria ka miratuar një plan të posaçëm veprimi për zgjidhjen e kësaj problematike.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

14. Kërkuesja pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur detyrimin e AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ lidhur me kompensimin në vlerë të pronës së kërkueses.

15. Gjykata, në jurisprudencë konstante, ka theksuar se ekzekutimi, brenda një afati të arsyeshëm, i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht dhe vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij kundrejt kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata ka theksuar se, pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 2, datë 1.2.2011; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, të sanksionuara në nenin 42/2 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 56, datë 21.12.2012, nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, dhe bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, në vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve merr në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 10, datë 1.3.2012; nr.*



49, datë 26.7.2012; nr. 56, datë 21.12.2012; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Edhe në çështjen konkrete në shqyrtim, vlerësimi për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor duhet të bëhet duke analizuar secilin nga elementet e mësipërme.

18. Lidhur me kompleksitetin e çështjes, për vlerësimin e tij duhet të merren parasysh të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke iu referuar çështjes konkrete në shqyrtim, e cila ka për objekt mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor për nxjerrjen e aktit administrativ nga ana e AKKP-së për kompensimin në vlerë të kërkesës, Gjykata vlerëson se ajo nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të AKKP-së.

19. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 50 datë 22.11.2011; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga aktet e kësaj çështjeje rezulton se, me kërkesën e datës 12.1.2009, kërkuarja i është drejtuar AKKP-së për të përfutur kompensimin financiar për pronën, por kjo e fundit është përgjigjur se kërkuarja duhet të aplikojë pas publikimit të afatit kohor për aplikim për vitin pasardhës, pasi afati për paraqitjen e kërkesave kishte përfunduar tashmë në datën 3.12.2008. Kërkuarja i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt detyrimin e AKKP-së të nxjerrë aktin administrativ përkatës për kompensimin në vlerë të pronës së saj. Pas dhënies së vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi nga gjykata e apelit, kërkuarja i është drejtuar AKKP-së për ekzekutimin vullnetar të tij. Kërkuarja i është drejtuar edhe Ministrit të Drejtësisë në mënyrë që të ushtrojë kompetencat ligjore, të parashikuara në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës, për ekzekutimin nga ana e AKKP-së të detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor. Me shkresën nr. 4101/1 prot., datë 27.12.2012, drejtuar Ministrit të Drejtësisë, AKKP-ja parashtron se nga verifikimet e kryera pranë këtij institucioni rezulton se kërkuarja nuk ka aplikuar për kompensim financiar dhe, në këto kushte, ky institucion nuk mund të shprehet me vendim për pronën e pretenduar. Po ashtu, ajo orienton subjektin të aplikojë pranë AKKP-së nga data 30.11.2012 deri në datën 28.12.2012, në përputhje me procedurat e përcaktuara në VKM-në nr. 768, datë 7.11.2011 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012”. Por edhe pas përgjigjes së AKKP-së dhe miratimit të VKM-së përkatëse për kriteret e shpërndarjes së fondit të kompensimit, kërkuarja nuk ka aplikuar pranë këtij organi për fillimin e procedurës së kompensimit në vlerë të pronës së saj, por ka vijuar të kërkojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

20. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëlloj (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 56, datë 21.12.2012; nr. 20, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Çështja në shqyrtim ka të bëjë me detyrimin e AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ për kërkesën për kompensim të kërkuarës Minerva Kotherja, në zbatim të vendimit nr. 1340, datë 24. 2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 11/d të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, për pronat e përcaktuara në këtë ligj, për të cilat është i pamundur kthimi fizik, shteti kompenson subjektet e shpronësuar me të holla, kurse, bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, kompetenca për pranimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për kompensim i përket AKKP-së. Për qëllim të zbatimit të kompensimit financiar, me ligjin nr. 10239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, është përcaktuar fondi i kompensimit të pronave, i cili përdoret për

kompensimin në vlerë të subjekteve të shpronësuara, të cilave u është njohur e drejta e kompensimit, kur kthimi fizik i pronës së tyre ka qenë i pamundur, fond, i cili po ashtu administrohet nga AKKP-ja. Bazuar në këtë ligj, subjektet e shpronësuara, të cilave u është njohur e drejta për kompensim, në përputhje me ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, përfitojnë kompensim nga fondi i kompensimit në masën dhe sipas mënyrës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili në bazë të të ardhurave të arkëtuara, miraton shumën në dispozicion të pronarëve dhe shtrirjen kohore të përfitimit të kësaj shume. Gjykata vëren se është Këshilli i Ministrave që përcakton shumën në dispozicion për kompensimin e ish-pronarëve, skemën e kompensimit, si dhe dokumentet që duhet të paraqiten nga subjektet. Vetëm pas paraqitjes së kërkesës nga subjektet e interesuara, brenda afateve të përcaktuara, AKKP-ja investohet me shqyrtimin e dokumentacionit dhe, pas verifikimeve që kryen, merr vendimin për pranimin apo refuzimin e kësaj kërkesë. Në qëndrimet e mbajtura nga AKKP-ja, lidhur me kërkesën Minerva Kotherja, nuk rezulton që ky organ të ketë refuzuar dhënien e kompensimit ndaj saj, por ka kërkuar që kërkesja të respektojë procedurën ligjore dhe të paraqesë kërkesë për kompensim brenda afateve të shpallura publikisht për këtë qëllim. Ndërkohë, kërkesja Minerva Kotherja, pasi i është drejtuar AKKP-së me kërkesën e datës 12.1.2009, ka iniciuar procesin gjyqësor dhe në vijim nuk ka paraqitur më kërkesë pranë këtij organi, edhe pas miratimit të VKM-së nr. 768, datë 7.11.2011 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012”.

22. Gjykata vëren se kërkesja, pas dhënies së vendimit gjyqësor të cilin ajo kërkon që të ekzekutohet, ka pasur mundësinë që të aplikojë pranë AKKP-së në afatet dhe kushtet e përcaktuara për këtë qëllim nga Këshilli i Ministrave, gjë të cilën nuk rezulton ta ketë bërë. Për më tepër, detyrimi i AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ, në zbatim të vendimit nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përbën një aspekt formal të procesit dhe jo një vendim përfundimtar që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për kompensimin e pronës. Rrjedhimisht, mosnxjerrja e aktit administrativ nga AKKP-ja nuk e pengon kërkesën të realizojë të drejtën materiale të kompensimit të pronës, nëpërmjet aplikimit dhe plotësimit të dokumentacionit përkatës të parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi.

23. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se është vetë kërkesja që me sjelljen dhe veprimet e saj ka shkaktuar vonesa në realizimin e të drejtës së saj, ndaj pretendimi për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha



MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të dalim me mendim pakice.

Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka konkluduar se është vetë kërkuesja që me sjelljen dhe veprimet e saj ka shkaktuar vonesa në realizimin e së drejtës së saj, ndaj pretendimi për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 1340, datë 24.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është i bazuar (*shih prg. 23 të vendimit*).

Në çështjen në shqyrtim, kërkuesja, në thelb, kërkon të realizojë të drejtën materiale të kompensimit të pronës dhe i është drejtuar gjykatës në funksion të realizimit të kësaj të drejte. Ndryshe nga shumica, mendojmë se sjellja e kërkueses nuk ka shkaktuar vonesa në realizimin e së drejtës për kompensim të pronës dhe nuk ka penguar ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, i cili është marrë pikërisht për vendosjen në vend të së drejtës së kompensimit. Në referencë të qëndrimit të pakicës, të shprehur edhe në vendimin nr. 20, datë 29.4.2013, konstatojmë se megjithëse VKM-ja për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit të pronarëve në të holla (VKM nr. 487, datë 6.5.2009) nuk ishte miratuar në momentin kur kërkuesja ka paraqitur kërkesën pranë AKKP-së (12.1.2009), kjo e fundit kishte mundësi të realizonte të drejtën e kompensimit në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, përkatësisht, ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, *të ndryshuar*¹, dhe VKM-së nr. 139, datë 13.2.2008, që përcaktonte hartën e vlerës së trojeve dhe çmimet përkatëse. Sipas nenit 16 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, *të ndryshuar*, zyra e AKKP-së bën shqyrtimin fillestar të kërkesës së subjektit të shpronësuar për kompensim dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në zbatim të përgjegjësive të veta për kompensimin, shprehet me vendim. Vendimi duhet të jetë në formë të shkruar, të arsyetuar, të nënshkruar nga titullari dhe të përmbushë kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative (KPA) për aktin administrativ. AKKP-ja, në rastin konkret, nuk është shprehur me vendim por i ka kthyer përgjigje kërkueses, duke i kërkuar të aplikojë për kompensim pas njoftimit të datës për aplikim (*shih prg. 3 të vendimit*), datë e cila do të përcaktohej në një akt nënligjor (VKM) që ende nuk ishte nxjerrë nga Këshilli i Ministrave. Kjo përgjigje e AKKP-së është e paqartë dhe nuk i plotëson garancitë dhe parashikueshmërinë në zbatimin e së drejtës dhe sistemit normativ që kërkon parimi i sigurisë juridike. Procesi i kthimit dhe kompensimit duhet të krijojë përshtypjen se subjektet e së drejtës se institucionet përgjegjëse do t’u përmbahen normave juridike në fuqi duke garantuar, me vendimmarrjen e tyre, siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen. Pasoja e parashikueshme për kërkuesin, i cili është subjekt i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës në dispozita të veçanta të tij, është marrja e vendimit, sipas ligjit, nga ana e AKKP-së, gjë të cilën kjo e fundit nuk e ka bërë. Ndaj, ndryshe nga shumica, çmojmë se AKKP-ja, e cila ka rolin kryesor në këtë proces, duke mos nxjerrë aktin administrativ përkatës, në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë, ka penguar realizimin e së drejtës për kompensim të kërkueses.

Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në kuptim të nenit 13 të Konventës, mjetet në dispozicion të një ndërgjyqësi *për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit* janë “efektive”, në qoftë se ato “parandalojnë shkeljen e pretenduar apo pengojnë vazhdimin e saj, apo ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur” (*shih Gjyli kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, prg. 53; Scordino kundër Italisë, nr. 1, datë 29.3.2006, prg. 183, 186*). Megjithatë, kur një vendim përfundimtar është dhënë në favor të një individi, ndaj shtetit, individi nuk duhet, si rregull, të jetë i detyruar të hapë procedurë të veçantë për zbatimin e vendimit (*shih Manushaqe*

¹ Ndryshuar me ligjin nr. 9583, datë 17.7.2006 dhe ligjin nr. 9898, datë 10.4.2008.

Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 17.12.2012, prg. 71; Metaxas kundër Greqisë, datë 27.5.2004).

Në çështjen në shqyrtim, nga aktet shkresore, del qartë se kërkesja i ka përmbushur të gjitha detyrimet procedurale që i takonin asaj dhe i ka ezauruar të gjitha mjetet ligjore që legjislacioni shqiptar i ka vënë në dispozicion. Ajo nuk disponon mjet tjetër efektiv për të realizuar të drejtën e kompensimit, duke pasur parasysh se sistemi juridik shqiptar nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë për të përshpejtuar procesin e kompensimit të pronës, me qëllim parandalimin e tejzgjatjes dhe zvarritjes së tij, dhe as për kompensimin e vonësive, që do të riparonte shkeljet *a posteriori*.

Duke pasur parasysh standardet e mësipërme të vendosura nga GJEDNJ-ja, si dhe në vështirësi të fakteve të çështjes konkrete, vlerësojmë se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, në kushtet e mospasjes së një mjeti tjetër efektiv, e ka penguar kërkesën të realizojë të drejtën materiale të kompensimit të pronës. Për pasojë, Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Sokol Berberi

VENDIM Nr. 3, datë 8.7.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Ardian Dvorani	kryesues
Ardian Nuni	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Majlinda Andrea	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Aleksandër Muskaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Medi Bici	anëtar
Shkëlzen Selimi	anëtar
Artan Zeneli	anëtar
Artan Broci	anëtar
Tom Ndreca	anëtar

në seancën gjyqësore publike të datës 8.7.2013 morën në shqyrtim çështjen penale nr. 3 akti që u përket palëve:

KËRKUES: Ylli Çelhaka

OBJEKTI: Kundërshtimin e urdhrit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr. 43, datë 2.4.2012, për ekzekutimin e vendimit penal nr. 19, datë 24.3.2000 (nr. 36, datë 23.4.2007) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

BAZA LIGJORE: Neni 463/1, 463/2, 464, 467, 470 e 471 të K. Pr. Penale.

Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, neni 55.



Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 13.6.2012, ka vendosur:

“- Rrëzimin e kërkesës.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit brenda afateve ligjore”.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 232, datë 25.7.2012, ka vendosur:

“- Ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm nr. 13 akti, datë 13.6.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë si më poshtë:

- Pranimin e kërkesës së të pandehurit Ylli Çelhaka, me objekt kundërshtimin e urdhrit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr. 43, datë 2.4.2012 “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. 19, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe anulimin e këtij urdhri për ekzekutimin e vendimit penal, si të pabazuar në ligj.

- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.”.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës ka paraqitur rekurs prokurori i Prokurorisë së Apelit Durrës, i cili ka kërkuar prishjen e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, duke parashtuar këto shkaqe:

- Me vendimin e gjykatës së apelit nuk jemi dakord, pasi është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural, është haptazi i paligjshëm, pasi pas prishjes së vendimit të formës së prerë nga Gjykata e Lartë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, i dënuari kthehet në pozitë të paraburgosurit, bie në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitës përkatëse procedurale por dhe me arsyetimin e vendimit nr. 19 (00-2012-279), datë 19.1.2012 të Gjykatës së Lartë.

- Mendojmë se në gjykimin e çështjes konkrete me objekt rishikimin e vendimit penal, jemi para kushteve ekstra procedurale, prandaj dhe dispozitat që lidhen me afatet e paraburgimit dhe procedurën e shqyrtimit të çështjes në tërësi, duhet t’u përshtaten këtyre kushteve, ku në rastin tonë konkret pyetjes se çfarë statusi merr personi pas prishjes së vendimit të formës së prerë e ka dhënë Gjykata e Lartë në vendimin e sipërcituar, për më tepër që pezullimi i vuajtjes së dënimit mund të bëhet ose nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjatë gjykimit të rishikimit ose nga trupi gjykues që gjykon çështjen konkrete.

- Me të drejtë gjykata e shkallës së parë konstaton se në rastin tonë konkret kërkuar Ylli Çelhaka ka qenë në kushtet duke vuajtur dënimin me burgim, pas ekzekutimit të vendimit të formës së prerë dhe prishja e këtij vendimi nga Gjykata e Lartë me qëllim rishikimin e tij nuk e ndalon vuajtjen e dënimit të kërkuar, pra shqyrtimi i çështjes me objekt rishikim vendimi do të vazhdojë në kushtet e vuajtjes së dënimit dhe jo në pozitë të paraburgimit.

- Në kuptim të dispozitës së nenit 454/1 të K. Pr. Penale, por edhe të vendimit të Gjykatës së Lartë, vuajtja e dënimit do të ndërpritej nëse do të kishim një vendim për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, ndërsa në rastin tonë konkret nuk kemi urdhër të tillë as nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, dhe as nga gjykata e caktuar për rigjykimin e çështjeve (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë), prandaj bazuar në këto dispozita procedurale dhe në vendimin nr. 279/19, datë 19.1.2012, arrihet në konkluzionin se pas pranimit të kërkesës për rishikim i gjykuar do të vazhdojë të vuajë dënimin, pasi vendimi i dënimit të tij është ende i ekzekutueshëm për aq kohë sa nuk është vendosur pezullimi i tij.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Shkëlzen Selimi dhe Mirela Fana; prokurorin Bujar Sheshi, i cili kërkoj prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit; mbrojtësin e kërkuar Ylli Çelhaka, av. Julian Kola, i cili kërkoj lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit; dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e faktit

Nga shqyrtimi gjyqësor në të dy shkallët e gjykimit rezultojnë të provuara këto rrethana fakti:

1. I gjykuari Ylli Çelhaka është akuzuar nga organi i ndjekjes penale, Prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për kryerjen e veprave penale të “Vrasjes me paramendim” dhe të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 78 dhe 278/2 të Kodit Penal. Kjo akuzë është ngritur pasi në datë 28.10.1997 ka qëlluar me armë zjarri duke vrarë viktimën Ardian Hima.

2. Procesi ndaj këtij të gjykuari është shqyrtuar në të gjitha shkallët e gjykimit duke rezultuar me disa vendime fajësie kundër tij.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 19, datë 24.3.2000, pasi ka shqyrtuar në themel kërkimin e organit të akuzës, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Ylli Çelhaka për veprën penale të “Vrasjes me paramendim”, parashikuar nga neni 78 i K.Penal dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ylli Çelhaka për veprën penale të “Armëmbajtjes pa leje”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.*

Në bashkim të dënimeve, në aplikim të nenit 55 të K. Pr. Penale, dënimin përfundimisht të të pandehurit Ylli Çelhaka me 20 vjet burgim ...”.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin penal nr. 141, datë 26.6.2000, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 19, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ...”.*

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 471, datë 12.12.2000, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i pandehuri Ylli Çelhaka dhe prokurori si të pabazuar në prova e në ligj”.*

6. Në të tilla rrethana rezulton se vendimi penal nr. 19, datë 24.3.2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka marrë formë të prerë.

7. Për ekzekutimin e këtij vendimi në datë 16.10.2006 është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr. 096 nga Prokurori i Rrethit Gjyqësor Kavajë. Ky vendim rezulton të jetë ekzekutuar në datë 17.10.2006, kohë në të cilën ka filluar llogaritja e vuajtjes së dënimit për të gjykuarin Ylli Çelhaka.

8. I dënuari Ylli Çelhaka ka paraqitur kërkesë për rishikim kundër vendimit të formës së prerë nr. 19, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, me pretendimin se pas përfundimit të gjykimit janë zbuluar prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi i dhënë është i gabuar.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 558, datë 2.6.2010, ka vendosur:

“Pranimin e kërkesës për rishikim të vendimit të të dënuarit Ylli Çelhaka.

Prishjen e vendimit nr. 471, datë 12.12.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të vendimit nr. 141, datë 26.6.2000 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit nr. 19, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për rigjykim, me tjetër trup gjykues”.

10. Pasi është regjistruar çështja dhe ka filluar **rigjykimi** në Gjykatën e Shkallës së Parë Kavajë, në seancën e datës 20.7.2011, i pandehuri (kërkuesi) Ylli Çelhaka i është drejtuar gjykatës me kërkesë me objekt: *“Shuarje e masës së sigurimit, si rezultat i humbjes së fuqisë së paraburgimit. Heqjen e masës së sigurimit “Arrest në burg”, caktimin si masë sigurimi atë të “detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, bazuar në nenet 261, 260/4, dhe 260/2 të Kodit të Procedurës Penale.*

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin penal nr. 13 akti, datë 20.7.2011, ka vendosur:

“Konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit për të pandehurin Ylli Alush Çelhaka.

Caktimin për të pandehurin Ylli Çelhaka të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.



I pandehuri Ylli Alush Çelhaka duhet të qëndrojë në banesën e babait të tij Alush Çelhaka me adresë lagjja nr. 5, rruga “Emigranti”, shtëpi private, Kavajë.

Urdhërohet Policia Gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.

Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetasit Ylli Alush Çelhaka, i biri i Alushit dhe i Verës, i datëlindjes 3.1.1974, nëse nuk mbahet i arrestuar për ndonjë vepër tjetër penale ...”.

12. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 179, datë 9.8.2011, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr. 13 akti, datë 20.7.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë”.

13. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 19, datë 19.1.2012, ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr. 179, datë 9.8.2011 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimin nr. 13, datë 20.7.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë dhe pushimin e gjykimit në lidhje e masën e sigurimit”.

14. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, gjatë kohës që çështja është duke u rigjykuar ndaj këtij të gjykuari, ka lëshuar urdhrin me nr. 043, datë 2.4.2012 për ekzekutimin e vendimit penal nr. 19, datë 24.3.2000 (nr. 36, datë 23.4.2007) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

15. Kundër lëshimit të urdhrin të ekzekutimit ka bërë ankim i gjykuari, i cili ka kërkuar pavlefshmërinë e tij duke pretenduar se urdhri i ekzekutimit është i paligjshëm, pasi nuk ka vendim gjykatë të formës së prerë apo vendim mase për të realizuar.

II. Procedurat gjyqësore

16. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin e ndërmjetëm të datës 13.6.2012, ka vendosur:

“Rrëzimin e kërkesës.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit brenda afateve ligjore.”

17. **Gjykata e Apelit Durrës**, me vendimin nr. 232, datë 25.7.2012, ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm nr. 13 akti, datë 13.6.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë si më poshtë:

Pranimin e kërkesës së të pandehurit Ylli Çelhaka me objekt kundërshtimin e urdhrin të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr. 43, datë 2.4.2012 “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. 19, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe anulimin e këtij urdhri për ekzekutimin e vendimit penal, si të pabazuar në ligj”.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.”.

18. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës ka paraqitur **rekurs prokurori** i Prokurorisë së Apelit Durrës, i cili ka kërkuar prishjen e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, duke parashtruar shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të vendimit.

III. Arsytimi i vendimit të ankimuar.

19. Gjykata e Apelit Durrës e ka gjetur të pabazuar në ligjin procedural vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke arsyetuar: “...Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në interpretim të gabuar të ligjit ka konsideruar vendim penal dënimin me burgim të formës së prerë për të pandehurin Ylli Çelhaka, vendimin nr. 19, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, vendim i cili rezulton të jetë prishur me vendimin penal nr. 00-2010-1084 (558), datë 2.6.2010 të Gjykatës së Lartë, duke e kthyer çështjen në ngarkim të të pandehurit Ylli Çelhaka për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më tej gjykata vazhdon: “...bazuar në N. 443 Gjykata e Lartë nuk ka disponuar në dispozitivin e saj se çështja duhet të priset pjesërisht, atëherë konkludohet se vendimi është prishur në tërësi; ..në rastin në shqyrtim m.q.s. çështja rezulton të jetë kthyer për rigjykim, duke prishur vendimet penale nr. 471, datë 12.12.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të vendimit nr. 141, datë 26.6.2000 të Gjykatës së Apelit Durrës, dhe vendimit nr. 19, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 00-2010-1084 (558), datë 2.6.2010 të Gjykatës së Lartë, atëherë i dënuari Ylli Çelhaka ka rimarrë cilësinë e të pandehurit....

Kjo gjykatë konkludon se i njëjti person nuk mund të marrë njëkohësisht dy cilësi si subjekt procedural penal në të njëjtin procedim penal dhe për të njëjtin fakt penal. Nga gjykata e shkallës së parë është njohur, cilësuar dhe proceduar shtetasi Ylli Çelhaka, si “i pandehur” dhe në vendimin e ndërmjetëm të datës 13.6.2012 e cilëson atë si “të dënuar”, me vendimin penal nr. 19, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për të njëjtin fakt juridik penal...”

20. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nisur nga fakti se ka interpretime jo të njëjta në lidhje me pozicionin e të gjykuarit mbasi kërkesa për rishikim pranohet, vendosi që për njehsimin e praktikës gjyqësore, në këtë drejtim, çështjen penale që i përket kërkuarit Ylli Çelhaka ta kalojë në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

IV. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara dhe qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara

21. Çështjet që shtrohen për t’u zgjidhur përpara Kolegjeve të Bashkuara me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore vlerësohen të jenë:

a) *Në rast se kërkesa për rishikim të vendimit të dënimit pranohet sipas nenit 453/3 të Kodit të Procedurës Penale², cila do të jetë pozita procedurale e të gjykuarit në fazën e rigjyimit të çështjes?*

b) *Në rast se vendimi i fajësisë pas rigjyimit të çështjes ndryshohet, ose i gjykuari shpallet i pafajshëm, cila do të jetë pozita procedurale nëse vazhdon procesi gjyqësor kundër tij?*

22. Qëndrimi i palëve në proces në lidhje me çështjet që duhet të unifikohen për efekt të njehsimin të praktikës dhe të pasojës që ka në lidhje me zgjidhjen e çështjes:

Prokurori mbajti qëndrimin se: “statusi i kërkuarit për rishikim të vendimit të dënimit, pas prishjes së vendimeve, mbetet po ai i të dënuarit dhe në kushtet kur dispozitat e kreut IV të K. Pr. Penale, në nenet 449 deri 460 të tij, nuk parashikojnë shprehimisht marrjen e masave të sigurimit personal (ndryshe nga disa legjislacione të ngjashme të disa vendeve të tjera që zbatojnë institutin e rishikimit), atëherë mbetet të bëhet interpretimi i këtyre dispozitave për të përcaktuar se në çfarë regjimi siguri do të mbetet i gjykuari deri në pritjen e vendimit përfundimtar.”.

Mbrojtësi i të gjykuarit Ylli Çelhaka mbajti qëndrimin se: “nga momenti që Gjykata e Lartë ka vendosur rishikimin e vendimit penal dhe çështja është dërguar për t’u rigjyuar, i pandehuri ka marrë cilësinë e të pandehurit në bazë të N.34/3 të K.Penal, i cili parashikon se: Cilësia e të pandehurit rimerret kur priset vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit. Ç’ka do të thotë se nga data 2.6.2010 mbi Ylli Çelhakën nuk ka rënduar një dënim penal me një vendim të formës së prerë dhe kështu në mungesë edhe të një mase siguri a mundet që ky i pandehur të qëndrojë në paraburgim për efekt të dënimit të mëparshëm”.

23. Kolegjet e Bashkuara e gjejnë me vend që paraprakisht është e nevojshme që, për t’i dhënë përgjigje çështjeve të shtruara për unifikim, të trajtojnë paraprakisht institutin e rishikimit i cili gjen rregullim në titullin VIII, kreun IV të K. Pr. Penale.

24. Rishikimi është mjet ankimi i jashtëzakonshëm dhe përjashtimor kundër një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë, i cili nuk mund të kundërshtohet nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit (apeli dhe rekursi).

Në këto kushte, kur janë shterur mjetet e zakonshme të ankimit, vendimi është i formës së prerë dhe çështja konsiderohet e mbyllur në bazë të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*). Në nenin 449 të K. Pr. Penale³ përcaktohet se cilët vendime mund të jenë objekt rishikimi.

² Neni 453/3 “Shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë”.

Kur kërkesa pranohet, Kolegji Penal vendos prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim nga një tjetër trup gjykues në gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj. Vendimi është i formës së prerë.

³ Nr. 449 i K. Pr. Penale “Vendimet që mund të rishikohen”

1. Në rastet e caktuara me ligj lejohet në çdo kohë rishikimi i vendimeve që kanë marrë formën e prerë, edhe kur dënimi është ekzekutuar ose është shuar.



25. Në nenin 34 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se: “*Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj*”.

26. Në këtë normë kushtetuese janë parashikuar tri nga parimet më të rëndësishme të procedurës penale: i) parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*); ii) parimi i sigurisë ligjore (*res judicata*); dhe iii) mundësia e rihapjes së çështjes penale si mundësi shmangie nga parimi i sigurisë ligjore.

27. Në lidhje me parimin e tretë mundësia e rihapjes së çështjes penale përcaktohet se ai mund të lejohet sipas rregullave të parashikuara në ligj dhe konkretisht në Kodin e Procedurës Penale. Në kapitullin e VIII-të “Ankimet”, kreun IV, është parashikuar “Rishikimi” si mjet i jashtëzakonshëm për të goditur një vendim përfundimtar, d.m.th. të cilit i kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit.

28. Shmangia nga parimi i sigurisë ligjore nëpërmjet rishikimit në kushtet e parashikuara nga ligji ka si qëllim ndreqjen e gabimit gjyqësor në dhënien e drejtësisë. Në lidhje me këtë çështje GJEDNJ-ja në disa çështje^{4,5} është shprehur se: “*Gjykata vlerëson se kërkesat e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat dhe nga karakteri substancial detyrues, ose kur ka arsye serioze legjitime që janë më me peshë se siguria juridike*”.

29. Rishikimi, si mjet ankimi i jashtëzakonshëm, është përfshirë në kreun IV ku janë parashikuar vendimet që mund të rishikohen, rastet e rishikimit, subjektet e legjitimuara, forma e paraqitjes, gjykimi dhe disponimi i Gjykatës së Lartë si gjykatë kompetente e caktuar me ligj për shqyrtimin e kërkesës për rishikim.

30. Karakteri “*extra ordinem*” i rishikimit del qartë nga vendosja e tij si mjet ankimi jashtë dhe përtej procesit të zakonshëm penal. Ndërkohë ankimi dhe rekursi si mjete ankimi në K. Pr. Penale, ndryshe nga rishikimi, janë përfshirë në fazat e procesit penal të gjykimit si mjete shteruese që çojnë në dhënien e një vendimi gjyqësor përfundimtar me pasojë zgjidhjen e çështjes.

31. Rishikimi si mjet i jashtëzakonshëm ankimi, sipas nenit 451 të K. Pr. Penale⁶, mund të jetë: i) *extra ordinem pro reo*; ose ii) *contra reum*.

32. Në rastin e parë *pro reo* rishikimi bëhet me kërkesë të të dënuarit me qëllimin për të provokuar një rivlerësim të së vërtetës në drejtimin e kundërshtimit të vendimit të fajësisë dhe të mundësisë që rihapja e procesit sjell potencialisht mundësinë e dhënies së një vendimi pafajësie. Në themel të rishikimit qëndron parimi se drejtësia duhet të jetë e vërtetë duke thyer kornizat procedurale të mbylljes përfundimtare të gjykimit.

33. Karakteri i jashtëzakonshëm i rishikimit si mjet ankimi del edhe nga fakti se ligjvënësi nuk e ka kufizuar brenda një afati kohor, ndërkohë që mjetet e zakonshme të ankimit duhet të paraqiten brenda afateve strikte kohore me pasojë papranueshmërinë e tyre.

34. Në rastin e rishikimit me kërkesë të prokurorit *contra reum* ka për objekt një vendim të gabuar pafajësie, i cili në këtë rast i shërben dhënies së drejtësisë me qëllimin e ndëshkueshmërisë së autorëve që kryejnë krime dhe për faj të sistemit gjyqësor ngelen të pandëshkuar. Në këtë rast qëllimi është që personat e deklaruar të pafajshëm me pa të drejtë të rigjykojnë dhe të dënohen për krimet e kryera, për pasojë procesi i ri i gjykimit mund të sjellë rëndimin *in pejus* të dënimit.

2. Vendimet e pafajësisë për krime mund të rishikohen me kërkesën e prokurorit, por me kusht që të mos kenë kaluar 5 vjet nga dhënia e vendimit.

⁴ Ryabykh kundër Rusisë nr. 52854/99, f. 52, ECHR 2003-IX).

⁵ Bratyakin kundër Rusisë nr. 53203/99, f. 63-68, 15 dhjetor 2005,

⁶ N.451 i K. Pr. Penale “**Kërkesa e rishikimit**”

1. Mund të kërkojnë rishikimin: a) i dënuari ose kujdestari i tij, dhe kur ai ka vdekur, trashëgimtari ose një i afërm i tij; b) prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin.

Ndryshe nga rasti i rishikimit që bëhet nga i dënuari, ligjvënësi e ka kufizuar në kohë kërkesën e prokurorit për të rishikuar një vendim pafajësie në një afat kohor prej 5 vjetësh, duke filluar ky afat nga dita e dhënies së këtij vendimi (neni 449/2 i K. Pr. Penale).

35. Shkaqet për të cilat mund të kërkohej rishikimi i një vendimi përfundimtar janë në funksion të qëllimit (*ratio*), i cili është dhënia fund pasojave të një vendimi të padrejtë i cili është përfundimtar.

36. Gjykimi i iniciuar nëpërmjet një kërkeje rishikimi në mënyrën se si është rregulluar në K. Pr. Penale në fuqi, ky institut kalon në dy faza procedurale, të cilat në varësi të faktit nëse kërkesa do të pranohet ose jo zhvillohen si faza të të njëjtit proces: e para është vlerësuese dhe e dyta gjyquese.

37. Faza vlerësuese zhvillohet në Gjykatën e Lartë e cila investohet mbi bazën e kërkesës së të gjykuarit (si edhe të personave të lidhur me të) ose të prokurorit, në të cilën vlerësohet nëse kërkesa për rishikim ka shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 450 të K. Pr. Penale⁷.

38. Kërkesa për t'u marrë në shqyrtim duhet të jetë e arsyetuar plotësisht mbi bazën e shkakut ligjor mbi të cilin ka lindur rishikimi i vendimit, e shoqëruar domosdoshmërisht me dokumentet provues, të cilat mbështesin pretendimin. Në këtë fazë të procesit rishikues Kolegji Penal në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, bën një vlerësim paraprak të karakterit formal dhe të ndikueshmërisë thelbësore që këto akte mund të kenë nëse shqyrtohen si prova nëse i hapet rrugë gjykimit rishikues.

39. Mandej kur kërkesa deklarohet e pranueshme, shqyrtimi i pranueshmërisë së kërkesës me qëllimin për t'i hapur rrugë rishikimit bëhet në prani të palëve, të cilët lejohen të debatojnë vetëm mbi shkaqet e rishikimit dhe jo mbi drejtësinë e vendimit që do të rishikohet.

40. Kjo fazë është thelbësore pasi përbën gjykimin e rishikimit në mënyrën *strictu sensu*.

Nëpërmjet debatit të palëve dhe vlerësimit të shkaqeve ligjore të përcaktuara në mënyrë të qartë, si dhe të dokumenteve provues në këtë fazë vlerësohet se këto akte vetëm ose të interpretuara bashkërisht janë në gjendje të japin një rezultat të ndryshëm të fajësisë apo të pafajësisë nga vendimi i cili rishikohet. Nëse kërkesa gjendet e bazuar në ligj, atëherë me vendim Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i hap rrugë rishikimit të vendimit të formës së prerë.

41. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se pavarësisht se në nenin 453/3 të K. Pr. Penale është përcaktuar se: “3. Kur kërkesa pranohet, Kolegji Penal vendos prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim....” në interpretimin integral të dispozitave të K. Pr. Penale, si dhe të funksionit të institutit të rishikimit termi “*prishje e vendimit*” nuk ka të bëjë me aspektin rishikues dhe atë kontrollues të gjykatave më të ulëta siç ndodh gjatë *iterit* të zakonshëm dhe të parashikuar në kapitullin e Gjykimit në Gjykatën e Lartë, por ka të bëjë me hapjen rrugë të procesit rishikues të një vendimi të formës së prerë. Për rrjedhojë, përfshi edhe pasojat juridike që prodhon, vendimi që do të rishikohet mbas pranimi të kërkesës për rishikim vazhdon të jetë në fuqi për të dënuarin. Ky përcaktim mbështet nga neni 454 të K. Pr. Penale, në të cilin parashikohet se: “1. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe gjykata e caktuar për rigjykimin e çështjeve mund të urdhërojnë pezullimin e ekzekutimit të vendimit”.

42. Në bazë të këtij rregullimi të pasojave juridike që vijnë nga vendimi i pranimi të kërkesës për rishikim, pranimi i kërkesës për rishikim dhe hapja rrugë e procesit të rishikimit mund të sjellë eventalisht edhe pasoja të menjëhershme në mënyrë incidentale për të dënuarin *in vinculis*, në lidhje me pezullimin e mëtejshëm të pasojave që vijnë nga ekzekutimi i mëtejshëm i vendimit,

⁷ N. 450 i K. Pr. Penale “**Rastet e rishikimit**”

1. Rishikimi mund të kërkohej: a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë; b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas; c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar; ç) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.



përfshi edhe vuajtjen e mëtejshme të dënimit me burgim.

43. Çështja e *status libertatis* në interpretim të përcaktimit që i jep ligji në rastin kur kërkesa për rishikim pranohet si një mundësi dhe jo si detyrim për gjykatën për të vendosur në favor të pezullimit të dënimit, e bën atë një kërkesë e cila mund të jetë autonome për të cilën mund të shprehet Kolegji Penal në fazën e pranimit të kërkesës dhe nga gjykata përkatëse në varësi të gjykatës që po zhvillon gjykimin rishikues dhe të fazës së këtij gjykimi me pasojë ekzekutimin e menjëhershëm dhe pa të drejtë ankimi.

44. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në përgjigje të çështjeve të shtruar për diskutim me qëllimin unifikimin e praktikës gjyqësore, arrijnë në qëndrimin unifikues se: **Në rastin kur kërkesa e të dënuarit pranohet dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në bazë të kompetencës rishikuese që ka sipas nenit 453 të K. Pr. Penale i hap rrugë procesit gjyqësor të rishikimit, i gjykuari do të vazhdojë të ketë statusin procedural të të dënuarit. Pranimi i kërkesës për rishikim nuk pas sjell në vetvete revokimin e dënimit as edhe lirimin e të dënuarit, por vetëm rihapjen e procesit gjyqësor për efekt të sqarimit të rrethanave të reja me qëllim që vendimi gjyqësor t'i përgjigjet të vërtetës. Ky fakt do të ndodhë vetëm nëse në zbatim të nenit 454 të K.Pr.Penale Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ose gjykata kompetente e cila do të gjykojë çështjen në rishikim, e çmon të nevojshëm pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur nga ecuria e procesit penal vazhdimi i mëtejshëm i vuajtjes së dënimit me burgim do të vinin pasoja të rënda të pariparueshme.**

Pranimi i kërkesës për rishikim nuk e ndryshon pozitën procedurale nga ajo e të dënuarit në atë të të pandehurit.

Në rast se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i hap rrugë rishikimit dhe në gjykimin rishikues në gjykatën e shkallës së parë i gjykuari deklarohet i pafajshëm pozicioni procedural i subjektit nuk është më ai i të dënuarit, por i të pandehurit. Kjo gjendje (statusi i të pandehurit) do të vazhdojë derisa vendimi i ri i pafajësisë i dhënë mbas rishikimit të marrë formë të prerë.

45. Gjykimi rishikues, mbasi i hapet rrugë kërkesës së rishikimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin ose në gjykatën e apelit kur kërkesa bëhet vetëm kundër këtij vendimi (neni 453/3 i K. Pr. Penale).

46. Shqyrtimi i ri gjyqësor rishikues si rregull zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë në një gjykim publik. Rregullat procedurale që ndiqen janë ato të parashikuara në kapitullin e gjykimin të shkallës së parë, duke mbajtur parasysh veçoritë e gjykimin rishikues.

47. Rishikimi i vendimit, duke qenë mjet i jashtëzakonshëm ankimi i një vendimi të formës së prerë, nuk pas sjell pavlefshmërinë e provave të marra dhe të përdorura në vendimin që do të rishikohet. Veçoria e këtij gjykimi qëndron në marrjen e atyre provave të cilat kanë shërbyer si shkak për pranimin e rishikimit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se gjykata që rishikon çështjen është e detyruar të marrë në rivlerësim provat të cilat kanë shërbyer në dhënien e vendimit pa ju futur edhe një herë shqyrtimit të tyre dhe duke e përqendruar hetimin gjyqësor vetëm në ato prova të cilat kanë shërbyer si objekt i kërkesës për rishikim e që janë përdorur si shkak për pranimin e rishikimit.

Në këtë proces rishikues vlerësimi i provave të reja do të jetë në tërësi së bashku me provat e tjera të shqyrtuara më parë me qëllimin që provat e reja së bashku ose në mënyrë të veçantë të çojnë gjykatën në konfirmimin e vendimit të parë që rishikohet, ose në një vendimmarrje të ndryshme.

48. Në rastin kur vendimi i rishikuar prishet atëherë vendimi i ri i pafajësisë në rast se kërkesa e rishikimit bëhet nga i dënuari pas sjell efektet juridike të cilat çojnë edhe në ndryshimin e statusit të të gjykuarit në atë të pandehurit, duke e futur procesin në *iter* të zakonshëm duke i dhënë të drejtën e ankimit dhe të kontrollit gjyqësor nëpërmjet mjeteve të zakonshme të ankimit. Në rast se kërkesa për rishikim rrëzohet dhe konfirmohet dënimi për të gjykuarin dhe është disponuar pezullimi

i ekzekutimit, atëherë ky vendim i humbet fuqinë dhe do të procedohet me vazhdimin e vuajtjes së dënimit me burgim.

49. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke iu kthyer zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi në bazë të qëndrimit unifikues, konstatojnë se vendimi i gjykatës së apelit në lidhje me anulimin e urdhrit të prokurorit për ekzekutimin e dënimit me burgim të caktuar me vendimin nr. 19, datë 24.3.2000 është marrë në kuptim dhe zbatim të gabuar të ligjit procedural penal në lidhje me pozitën procedurale të të gjykuarit Ylli Çelhaka, mbasi vendimi penal i dënimit është bërë objekt rishikimi.

50. Në bazë të akteve të fashikullit të gjykimit, rezulton se i gjykuari Ylli Çelhaka është deklaruar fajtor me vendimin penal të formës së prerë për veprën penale të vrasjes me dashje dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 78 dhe 278/2 të Kodit Penal. Ky vendim është bërë objekt rishikimi mbi bazën e kërkesës së të dënuarit, kërkesë e cila është pranuar nga Kolegji Penal, i cili ka vendosur t'i prishë vendimet duke i hapur rrugë rishikimit dhe dërgimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë Kavajë si gjykata kompetente. Nuk rezulton që as Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe as gjykata e cila po gjykon çështjen mbas rishikimit të ketë disponuar me vendimin për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.

51. Gjatë gjykimit rishikues në shkallë të parë, i dënuari Ylli Çelhaka ka ngritur pretendimin se vendimi i dënimit me burgim është prishur dhe vuajtja e dënimit nuk duhet të vazhdojë. Për këtë shkak ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe caktimin e masës së sigurimit detyrim paraqitje. Kjo kërkesë, e cila është paraqitur gjatë rishikimit të vendimit, është pranuar nga të dy gjykatat e faktit duke i caktuar si masë sigurimi “arrest në shtëpi” me arsyetimin se statusi i tij ka ndryshuar nga “i dënuar” në “i pandehur” dhe për shkak të plotësimit të afatit tërësor të paraburgimit.

52. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e prokurorit, e ka marrë në shqyrtim çështjen duke vendosur pushimin e gjykimit të kërkesës për shkak të interpretimit të gabuar që gjykatat i kanë bërë statusit procedural të të dënuarit. Më pas i gjykuari ka kundërshtuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori, duke pretenduar se vendimi për të cilin kërkohet ekzekutimi pas hapjes së procedurës së rishikimit nuk është më i ekzekutueshëm.

53. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vazhdim të qëndrimit unifikues të përmendur më sipër, çmojnë se vendimi i gjykatës së apelit është i gabuar dhe jo në interpretim të drejtë të ligjit dhe për pasojë duhet të prishet duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

54. Ky vendim ka ardhur si rezultat i moskuptimit të drejtë të pozicionit procedural të të dënuarit Ylli Çelhaka mbasi është pranuar kërkesa për rishikim. Konstatohet nga aktet se megjithëse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar kërkesën për rishikim të Ylli Çelhakës nuk ka disponuar në vendim për pezullimin e ekzekutimit të mëtejshëm të dënimit. Po ashtu edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë gjatë rishikimit të çështjes nuk ka disponuar me vendim pezullimi; fakte këto që nuk i ndërpresin pasojat që vijnë nga vendimi nr. 19, datë 24.3.2000 dhe vendimit nr. 141, datë 26.6.2000 që kërkohet të rishikohen, përfshi edhe vuajtjen e dënimit me burgim.

55. Megjithëse pozicioni procedural i të gjykuarit Ylli Çelhaka si i dënuar është sqaruar nga Kolegji Penal në vendimin e rrëzimit të kërkesës për masë sigurimi, përsëri nga Gjykata e Apelit Durrës në kërkesën për rrëzimin e kërkesës është arsyetuar në drejtim të humbjes së fuqisë ekzekutive të vendimit për shkak të rishikimit të tij. Ky vlerësim është i gabuar, pasi, ashtu siç arsyetohet më lart, i gjykuari Çelhaka vazhdon të ketë statusin e të dënuarit edhe në fazën e vlerësimit të kërkesës së tij për rishikim dhe për aq kohë sa në bazë të nenit 454/1 të K. Pr. Penale nuk është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit, ai do të vazhdojë të vuajë dënimin me burgim.



56. Urdhri i ekzekutimit të vendimit të dënimit është akt procedural, të cilin ligji ia jep prokurorit si subjekt procedural i cili ndjek dhe zbaton ekzekutimet e vendimeve gjyqësore. Lëshimi i tij bëhet në rastet e parashikuara nga neni 462 i K. Pr. Penale⁸, ku një ndër to është edhe ekzekutimi i vendimit të formës së prerë. Siç rezulton nga aktet në lidhje me ekzekutimin e vendimit nr. 19, datë 24.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Kavajë, prokurori rezulton të ketë lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit datë 16.10.2006. Ky vendim rezulton të jetë ekzekutuar në datë 17.10.2006, kohë në të cilën ka filluar llogaritja e vuajtjes së dënimit për të gjykuarin Ylli Çelhaka. Mbas lirimit të të gjykuarit, me vendimin gjyqësor nr. 13, datë 10.2.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, i cili është vendim me ekzekutim të menjëhershëm, i gjykuari Ylli Çelhaka ka fituar lirinë e përkohshme. Vendimi është konsideruar i padrejtë dhe është rrëzuar kërkesa nga Kolegji Penal për kalimin e tij nga vuajtje dënim për efekt të vendimit të formës së prerë në masë sigurimi. Në rregullim të pasojave që sjell ky vendim prokurori ka lëshuar urdhrin e ri të ekzekutimit për vazhdimin e vuajtjes së dënimit.

57. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se Gjykata e Apelit të Durrësit ka gabuar në interpretimin e nenit 454 të K. Pr. Penale në lidhje me statusin e kërkuarit Ylli Çelhaka gjatë rishikimit duke e konsideruar si të pandehur. Ashtu siç është përmendur më lart, prishja e vendimit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim, duke qenë se rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm i cili jep mundësinë e vlerësimit të vendimit gjyqësor dhe jo të procesit gjyqësor, ka të bëjë vetëm me efektet e pranimin të kërkesës për rishikim dhe të drejtën që ka gjykata kompetente për të vlerësuar drejtësinë procedurale me qëllimin që të korrigjohet gabimi që ka ardhur duke arritur në një konkluzion që i përgjigjet të vërtetës.

58. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka përcaktuar pozicionin procedural të kërkuarit si i dënuar në lidhje me kërkesën e tij dhe në kushtet kur nuk kishte një vendim të posaçëm në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim ka rrëzuar kërkesën e tij për anulimin e urdhrin të ekzekutimit. Arsyetimi ligjor i kësaj gjykate mbështetet në të drejtën që ka prokurori që, në varësi të statusit procedural që ka i gjykuari, në efektet e vendimit gjyqësor të procedojë në ekzekutimin e tij nëpërmjet lëshimit të urdhrin të ekzekutimit.

V. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

59. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në konkluzionin se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe si i tillë do të priset duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 438/2 e 444/1, germa “d” të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

- Prishjen e vendimit nr. 232, datë 25.7.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 13 akti, datë 13.6.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

- Ky vendim është unifikues dhe njehson praktikën gjyqësore për çështjet objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

⁸ Nr. 462 /1 K. Pr. Penale “Vendimet e ekzekutueshme”.

1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë.

Anëtarë pro: Ardian Dvorani (kryesues), Guxim Zenelaj, Ardian Nuni, Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Aleksandër Muskaj, Mirela Fana, Andi Çeliku, Shkëlzen Selimi, Artan Zeneli, Artan Broci, Tom Ndreca.

Anëtarë pjesërisht kundër: Majlinda Andrea, Medi Bici.

MENDIM PAKICE

Ne, gjyqtarët **Majlinda Andrea** dhe **Medi Bici**, jemi pjesërisht kundër vendimit nr. 3, datë 8.7.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për sa i përket pozitës procedurale që merr i dënuari pas prishjeve të vendimeve të gjykatave si pasojë e pranimi të kërkesës së rishikimit nga Gjykata e Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, prandaj, në përputhje me nenin 112/5 të K. Pr. Penale, përpilojmë këtë procesverbal përmbledhës me motivet e kundërshtimit të vendimit.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes ka rezultuar si më poshtë:

Kërkuesi Ylli Çelhaka është akuzuar nga organi i prokurorisë për veprat penale të vrasjes me paramendim dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 78 dhe 278/2 të Kodit Penal për ngjarjen e ndodhur më datë 28.10.1997 në Rrethin e Kavajës, ku ka mbetur i vrarë me armë zjarri viktimë Ardian Hima.

Me vendimin nr. 19, datë 24.3.2000 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë e ka deklaruar fajtor të pandehurin Ylli Çelhaka për veprat penale për të cilat akuzohej, duke e dënuar atë përfundimisht me 20 vjet burgim, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës dhe është vendosur mospranimi i ankimit në Gjykatën e Lartë.

Në datën 16.10.2006 Prokuroria pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin e formës së prerë, i cili është ekzekutuar nga organet kompetente me datë 17.10.2006, kohë kur ka filluar edhe llogaritja e dënimit për kërkuesin Ylli Çelhaka.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 558, datë 2.6.2010 ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim të paraqitur nga i dënuari Ylli Çelhaka, duke prishur vendimet e gjykatave dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjatë rigjykimit në shkallë të parë, kërkuesi ka kërkuar shuarjen e masës së sigurimit të arrestit në burg me pretendimin se ajo e ka humbur fuqinë për shkak të kalimit të afatit të përgjithshëm të paraburgimit, të parashikuar nga neni 261 e vijues i K. Pr. Penale.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 13 akti, datë 20.7.2011, ka vendosur konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit të arrestit në shtëpi, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 19, datë 19.1.2012 ka vendosur prishjen e vendimeve të mësipërme dhe pushimin e gjykimit të çështjes në lidhje me masën e sigurimit të arrestit në burg.

Në zbatim të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit që është ankuar nga kërkuesi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila në përfundim të gjykimit ka vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim që është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila ka pranuar kërkesën e kërkuesit, duke anuluar urdhrin e ekzekutimit të lëshuar nga prokuroria me datë 2.4.2012, me të cilin kërkohej që të ekzekutohej edhe një herë vendimi nr. 19, datë 24.3.2000 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.



Pakica ndan të njëjtin mendim me shumicën në lidhje me unifikimin e praktikës gjyqësore, por nuk është e të njëjtit mendim me të për sa i përket pozitës procedurale që merr personi që ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë, i cili është prishur më pas nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë si pasojë e pranimit të kërkesës për rishikim.

Është e vërtetë që rishikimi i vendimit është një mjet ankimi i jashtëzakonshëm, me anë të cilit i dënuari mund të mbrohet ndaj vendimeve penale të formës së prerë, por ndryshimi ndërmjet tij dhe rekursit ndaj vendimit të formës së prerë nuk është ai që arsyetojnë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku sipas tyre rishikimi ndaj vendimeve të formës së prerë, i parashikuar nga neni 432 i K. Pr. Penale, i prish në “substancë” vendimet e gjykatave, ndërsa instituti i rishikimit nuk e ka një fuqi të tillë.

Pakica vlerëson se rishikimi, ashtu edhe rekursi ndaj vendimeve të formës së prerë, i parashikuar nga neni 432 i K. Pr. Penale, janë mjete ankimi që mund të përdorin palët ndaj vendimeve të formës së prerë, prandaj në këtë kuptim ato nuk kanë ndonjë ndryshim nga njëri-tjetri.

Sipas vlerësimit të pakicës ndryshimi ndërmjet tyre qëndron në faktin se rekursi ndaj vendimit të formës së prerë, i parashikuar nga neni 432 i K. Pr. Penale, paraqitet vetëm ndaj vendimeve të formës së prerë të dhëna nga gjykata e apelit, ndërsa rishikimi, i parashikuar nga neni 449 e vijues i K. Pr. Penale, mund të kërkohej ndaj vendimeve të formës së prerë të dhëna nga të gjitha gjykatat.

Ndryshimi tjetër ndërmjet tyre qëndron në faktin se ato paraqiten për shkaqe të ndryshme nga njëri-tjetri, sepse rekursi ndaj vendimit të formës së prerë paraqitet për shkaqet e parashikuara nga neni 432 i K. Pr. Penale, ndërsa kërkesa për rishikim paraqitet vetëm për shkaqet e parashikuara nga neni 450 i K. Pr. Penale, por duhet theksuar se në rastin e pranimit të tyre rezultati është gjithmonë i njëjtë, që është prishja e vendimeve të formës së prerë nga ana e Gjykatës së Lartë.

Pakica vlerëson se arsyetimi që bën shumica bie në kundërshtim me kreun IV të K. Pr. Penale (neni 449 e vijues i K. Pr. Penale), pasi sipas ligjit tonë procedural penal, Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim nuk vendos vetëm për pranimin ose jo të kërkesës për rishikim dhe disponimin mbi vendimin e themelit ua delegon gjykatave më të ulëta, përkundrazi, ajo, pasi pranon kërkesën për rishikim, prish vendimet e dhëna nga të gjitha gjykatat e të tria niveleve dhe më pas e dërgon çështjen për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

Nëse Gjykata e Lartë do të vendoste vetëm pranimin e kërkesës për rishikim, pa disponuar mbi vendimet e marra nga gjykatat, atëherë pakica do të pajtohej plotësisht me vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por kështu siç është formuluar kreu IV në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë nuk lihet asnjë hapësirë për të bërë interpretimin që ka bërë shumica, sepse pas pranimit të kërkesës për rishikim dhe prishjes së vendimeve nga Gjykata e Lartë nuk ekziston më asnjë vendim dënimi, prandaj personi ndaj të cilit vazhdon procedimi penal, menjëherë pas pranimit të kërkesës për rishikim dhe prishjes së vendimeve nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, merr automatikisht cilësinë e të pandehurit dhe gëzon të gjitha të drejtat e tij gjatë proceseve të mëpasshme gjyqësore.

Me këtë vendim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar praktikën gjyqësore në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, por ato nuk e kanë sqaruar gjykatën e rishqyrtimit të çështjes se si do ta konsiderojë ajo kërkesin Ylli Çelhaka gjatë rishqyrtimit të çështjes në shkallë të parë (të pandehur, të gjykuar apo të dënuar), në një kohë që ndaj tij nuk ekziston asnjë lloj vendimi dënimi.

Nga ana tjetër, shumica nuk arsyeton në vendim se si do të jetë pjesa hyrëse e vendimit përfundimtar që do të japë gjykata e shkallës së parë pas rishqyrtimit të çështjes (si do të quhet kërkesi: i dënuar, i gjykuar apo i pandehur) dhe nuk shpjegon se si do të jetë dispozitivi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në një kohë kur në arsyetimin e vendimit thuhet se: *kur gjykata e shkallës së parë prish vendimet dhe jep pafajësi masa e sigurimit shuhet.*

Pakica vlerëson se qëndrimi që mban shumica është i pabazuar në ligj, sepse gjatë rishqyrtimit të çështjes në shkallë të parë kërkuesi duhet të mbajë cilësinë e të pandehurit, gjykata e shkallës së parë në përfundim të gjykimit nuk mund të shprehet për prishjen e vendimeve, pasi ato i ka prishur më parë Gjykata e Lartë, por ajo duhet t'i hyjë shqyrtimit në themel të çështjes, duke marrë edhe provat e reja të pretenduara nga palët gjatë rishikimit dhe në përfundim duhet të dalë me vendim fajësie, pafajësie ose kur janë rastet e parashikuara nga nenet 387 dhe 328 të K. Pr. Penale vendos pushimin e çështjes penale.

Arsyetimi i mësipërm e çon pakicën në përfundimin se rishikimi i vendimit si mjet i jashtëzakonshëm ankimi ndaj vendimeve të formës së prerë duhet të shqyrtohet me shumë kujdes, duke mos e kthyer atë në një mjet të zakonshëm mbrojtjeje, sepse në rast pranimi të kërkesës për rishikim sipas ligjit tonë procedural penal të gjitha vendimet e dënimit të dhëna nga gjykatat nuk ekzistojnë më, prandaj rezultati i tij është i njëjtë si në rastin e pranimi të rekursit ndaj vendimeve të formës së prerë, të parashikuara nga neni 432 i K. Pr. Penale ku personi i dënuar pas prishjes së vendimit të formës së prerë merr cilësinë e të pandehurit.

Në raste të tilla gjykata e rishqyrtimit të çështjes, edhe kryesisht, është e detyruar që të verifikojë shuarjen e masës së sigurimit të arrestit në burg, të parashikuar nga neni 238 i K. Pr. Penale dhe, nëse konstaton ndonjërin prej rasteve të parashikuara nga neni 261 i K. Pr. Penale, ajo është e detyruar që të vendosë shuarjen e masës së sigurimit të arrestit në burg, sepse në të kundërt shkelet neni 27/1 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe neni 5 i Konventës së të Drejtave të Njeriut, të cilat parashikojnë se askush nuk mund të mbahet në burg pa pasur një vendim dënimi të dhënë nga gjykata, në një kohë që masa e sigurimit e vendosur nga gjykata për veprat penale që akuzohet i dënuari është shuar në përputhje të plotë me nenin 261 të K. Pr. Penale.

Për të gjitha këto u thanë më sipër, pakica është plotësisht e bindur se vendimi nr. 3, datë 8.7.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në pjesën që unifikon praktikën gjyqësore në lidhje me cilësinë që merr personi i dënuar pas pranimi të kërkesës së tij për rishikimin e vendimeve dhe prishjes së tyre nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është i pabazuar në ligj, prandaj vota jonë është pjesërisht kundër tij.

Gjyqtarë: Medi Bici, Majlinda Andrea

VENDIM Nr. 95, datë 13.9.2013

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË TAP AG, PËR MODIFIKIM TË PËRKUFIZIMIT TË ORIGINËS SË GAZIT, SIPAS PIKËS 4.1.1 TË VENDIMIT PËR MIRATIMIN E OPINIONIT TË PËRBASHKËT PËRFUNDIMTAR

Në zbatim të:

- Ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;
- Vendimit nr. 39, datë 23.4.2012 “Për miratimin e udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në Projektin Trans Adriatik Pipeline (TAP), sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC”, nëpërmjet të cilit ERE adoptoi direktivën 2009/73/EC si bazë për shqyrtimin e mëtejshëm të aplikimit për përjashtime të TAP AG, së bashku me Autoritetin Rregullator të Energjisë të Italisë, AEEG dhe Autoritetin Rregullator të Energjisë të Greqisë, RAE;
- Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Direktiva);



- Rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009; (në tekstin e mëtejshëm: rregullorja ACER);
- Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009;
- Vendimit nr. 27, datë 1.3.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP – AG, prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për Projektin Trans Adriatik Pipeline”, nenit 22, pika 4 e direktivës 2003/55/EC, të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës;
- Vendimit të Komisionit Evropian C(2013) 2949 të 16 maj 2013;
- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013);
- Vendimit nr. 64, datë 13.6.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE “Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE, nr. 27, datë 1.3.2013 “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”, për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Evropian C(2013) 2949”;
- Kërkesës sipas pikës 4.1.1 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar në lidhje me zgjerimin e kuptimit të termit “Origjina e gazit” të dërguar nga ana e TAP, të datës 12.8.2013, prot. nga ERE me nr. 223/9, datë 23.8.2013 (në vijim: letra e 23 gushtit 2013);
- Dhe duke marrë në konsideratë se:
- Shoqëria TAP AG, mbështetur në nenin 40 pika 5 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Energjisë (në vijim: ERE) një kërkesë për përjashtim, duke iu referuar një projekti për një interconektor të ri që përshkon Greqinë, Shqipërinë dhe përfundon në Itali (në vijim: gazsjellësi TAP), dhe kjo sjell, që për qëllime shqyrtimit të kërkesës për përjashtim, të nevojitet përfshirja e autoriteteve rregullatore homologe (në vijim: autoritetet); për Shqipërinë: Enti Rregullator i Energjisë (ERE), për Greqinë: Regulatory Authority for Energy (RAE) dhe për Italinë: Autorita për L’Energia Elettrica e il Gas (AEEG);
- ERE me vendimin nr. 27, datë 1.3.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ka miratuar Opinionin e Përbashkët, si rrjedhojë e vlerësimit pozitiv të autoriteteve përgjegjëse për dhënien e vendimit të përjashtimit me kushte;
- Me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, janë miratuar rekomandimet shtesë të paraqitura nga ana e Komisionit Evropian, lidhur me pjesën 4 të Opinionit të Përbashkët (Opinionit i Përbashkët Përfundimtar);
- Opinionit i Përbashkët Përfundimtar (Final Joint Opinion) parashikon në paragrafin 4.1, pika 1, që për sa i përket origjinës së gazit të transportuar përmes kapacitetit objekt përjashtimit të TAP AG të jetë gazi i prodhuar nga faza e dytë e vendburimit Shah Deniz (Shah Deniz II) dhe që çdo modifikim prej këtij parashikimi të jetë objekt miratimi paraprak nga ana e autoriteteve;
- Shoqëria TAP AG ka kërkuar, me letrën e 23 gushtit 2013, që të specifikohet përkufizimi i gazit të Shah Deniz II, në mënyrë që nën termin e gazit të Shah Deniz II, në kuptim të pikës 4.1.1 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar të përfshihet, gjithashtu, gaz i prodhuar edhe nga vendburime të tjera të vendosura në territorin e Azerbajxhanit;
- Një modifikim i tillë nuk është në kundërshtim me arsyet, mbi bazën e të cilave është miratuar përjashtimi nga ana e ERE-s dhe në veçanti pikës 36.1 të direktivës 73/2009/CE që parashikon ndër të tjera, që infrastruktura e re të rrisë sigurinë e furnizimit;
- Siguria e furnizimit varet edhe nga diversifikimi i burimeve të gazit dhe modifikimi i propozuar nuk e ndryshon këtë skenar, duke qenë se gazi do të jetë gjithsesi i prodhuar në territorin e Azerbajxhanit;

Mbështetur në sa me sipër:

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2013, duke konsideruar se nuk ka asnjë pengesë për miratimin e modifikimit të kërkuar nga ana e TAP AG, që lejon shoqërinë TAP AG të transportojë gazin e prodhuar në territorin e Republikës së Azerbajxhanit, pavarësisht nga vendburimi specifik i prodhimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë që përcaktimi i termit “Gazit i Shah Deniz II” në pikën 4.1.1 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion të jetë “gas transported through the TAP produced from the gas fields in the territory of the Republic of Azerbaijan and supplied under the relevant Shah Deniz Gas Sales Agreements”.

2. Njoftimin e TAP AG për marrjen e këtij vendimi.

3. Njoftimin e autoriteteve rregullatore të energjisë të Italisë (AEEG) dhe Greqisë (RAE) për marrjen e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo**

VENDIM

Nr. 96, datë 13.9.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“BARDHGJANA” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC
“BISAK”, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, dhe neneve 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 13.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Bardhgjana” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Bisak”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Bardhgjana” sh.p.k. është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Bardhgjana” sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Bisak” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

VENDIM
Nr. 98, datë 13.9.2013

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SHPK ME NR. 112, SERIA PV10K, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 110, DATË 22.12.2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 3 pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 112, seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 110, datë 22.12.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë “Energy Plus” me numër 112, seri PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Pobreg”, me fuqi 9 MW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 110, datë 22.12.2010.

2. Fuqia totale e instaluar e hec “Pobreg” nga 9 MW të bëhet 12,3 MW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

VENDIM
Nr. 99, datë 13.9.2013

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT DHE TË TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “HEC-LANABREGAS” SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 3, pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, në mbledhjen e tij të datës 13.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a., për ndryshimin e licencës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Hec-Lanabregas” sh.a., dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës me nr. 145, seria PV11SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve me nr. 134, datë 6.12.2011 në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe licencës me nr. 147, seria TPV11SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 137, datë 6.12.2011 në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Hec-Lanabregas” sh.a.

2. Mbajtës i licencave të mësipërme do të jetë shoqëria “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo



VENDIM
Nr. 100, datë 13.9.2013

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRIVE
“HEC BISTRICA 1, BISTRICA 2” SHA, “HEC ULËZ SHKOPET” SHA, PËR
TRANSFERIMIN E ASETVE DHE TË LICENCAVE TË PRODHIMIT, TREGTIMIT DHE
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KËTO SHOQËRI
TE SHOQËRIA “KURUM INTERNATIONAL” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 dhe të nenit 20 pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 17 pika 4 gerat “a”, “b”, “c” të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, pikës 1.3 të licencës së aktivitetit të tregtimit dhe të furnizuesit të kualifikuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 13.9.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përparitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërive “Hec Bistrica 1, Bistrica 2” sh.a., “Hec Ulëz Shkopet” sh.a., për transferimin e licencave të prodhimit, tregtimit dhe furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike nga këto shoqëri te shoqëria “Kurum International” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë “Kurum International” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo

KËRKESË

Shtetasja Liljana Arapi, e bija e Vangjelit dhe e Andromahit, e datëlindjes 3.12.1953, lindur në Tiranë dhe banuese në Levan-Fier, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier shpalljen të zhdukur të djalit të saj Rudin Arapi.

KËRKUESE
Liljana Arapi

KËRKESË

Shtetasi Kacandon Memushaj, i biri i Nebiut dhe i Fatimes, i lindur dhe banues në fshatin Gjorm, komuna Brataj, Vlorë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen të zhdukur prej datës 1.9.1993 të vëllait të tij, shtetasit Veliko Memushaj.

KËRKUESI
Kacandon Memushaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 11.10.2013
Doli nga shtypi më 11.10.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 42 lekë